



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK  
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE  
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 3231/

Tirane, date 23.11.2015

Drejtuar: Z. ILIRJAN DINELLARI  
SHOQERIA "2D" SH.P.K  
FSHATI LUMALAS

KORÇE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV  
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR  
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE  
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.590 date 26.12.2000.

I nderuar zoti Dinellari,

Shoqëria "2D" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.590 date 26.12.2000, për mineral qymyr guri, ne objektin "Qencke", ne Qarkun Korçe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 3926 date 08.04.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.3231 date 14.04.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.590 date 26.12.2000, për mineral qymyr guri, ne objektin "Qencke", ne Qarkun Korçe, për arsye se"

- Nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar.
- Është pezulluar puna për me shume se një vit pa njoftuar me pare strukturat përgjegjëse siç përcaktohet ne germën "dh" te nenit 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "c" dhe germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.590 date 26.12.2000, për mineral qymyr guri, ne objektin "Qencke", ne Qarkun Korçe, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.590 date 26.12.2000.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJINURI

